

## Informacion i Përgjithshëm Periodik Q4-2021

Raiffeisen Bank sh.a, është shoqëri aksionare me seli në "Rruga e Kavajës, Pall 71, Shk.1, Ap.4, Tiranë", e themeluar me datë 10.06.1997 dhe e regjistruar ne regjistrin tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 17426, date 10.07.1997. Numri Unik i Regjistrimit te Subjektit (NUIS) eshte J61911005B.

Kapitali: 14.178.593.030 lekë

Vlera e kapitalit të shlyer: 14.178.593.030 lekë

Numri i aksioneve: 7.000,000

Aksione të zakonshme me vlerë nominale secili: 2.025.513,29 lekë

Aksioner i vetëm: Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Am Stadtpark 9 Wien, Austri, mbajtës i 100% të aksioneve.

Raiffeisen Bank sh.a është pjesë e grupit ndërkombëtar Raiffeisen Bank International AG (RBI), grup i cili është një ndër liderët kryesorë në Austri dhe që është i shtrirë në mesë 15 shtete të Europës Qëndrore dhe Lindore me anë të bankave të rrjetit. Raiffeisen Bank International AG zotërohet nga Raiffeisen Zentralban Osterreich AG (RZB) e cila mban rreth 60.7 përqind të aksioneve ndërsa pjesa tjetër, janë aksione të kuotuar lirisht në bursë dhe zotërohen nga investitorë privatë.

Raiffeisen Bank sh.a zotëron në Republikën e Shqipërisë shoqëritë e më poshtme:

- 100% të aksioneve të *Raiffeisen Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive* me adresë në "Tiranë, Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, kati i 2"
- 100% të aksioneve të *Raiffeisen Leasing Sh.a* me adresë në "Tiranë, Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2,,kati i 7"

Raiffeisen Bank sh.a ushtron aktivitetet bankar në Republikën e Shqipërisë bazuar në Licencën nr. 02/1 akorduar nga Banka e Shqipërisë, duke ofruar shërbimet/produktet si vijon:

- ✓ Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore;
- ✓ Qiranë financiare;
- ✓ Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- ✓ Ofrimin e garancive;
- ✓ Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
  - i) Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata të depozitave etj),

- ii) Këmbim valutor,
  - iii) Produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options),
  - iv) Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen,
  - v) Letra me vlerë të transferueshme,
  - vi) Instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare duke përfshirë veprimet me arin,
  - vii) Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime,
- ✓ Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit ;
  - ✓ Ndërmjetësimin për transaksione monetare të më poshtme:
    - i) Administrimin e aktiveve të tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit,
    - ii) Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumenta të tjera të negociueshme.
  - ✓ Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, ceqet e udhëtarit dhe ceqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj, përfshirë emetimin e parasë elektronike.
  - ✓ Shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e përfshira në licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.
  - ✓ Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare.
  - ✓ Ndërmjetësim në sigurime dhe risigurime.

## **Struktura dhe pergjegjesite e Organeve Drejtuese**

### **Keshilli Drejtues:**

Peter Lennkh	- Kryetar
Heinz Wiedner	- Zëvendëskryetar
Harald Kreuzmair	- Anëtar
Slavoljub Dordevic	- Anëtar
Thomas Matejka	- Anëtar

## **Pergjegjesite:**

**Këshilli drejtues** ka përgjegjësitë kryesore, të cilat përfshijnë, midis të tjerave:

- a) miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor;
- b) përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;
- c) monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;
- ç) krijimin e komiteteve, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
- d) përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;
- dh) monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
- e) marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
- ë) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;
- f) mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

## **Komiteti i Kontrollit**

Heinz Wiedner	- Kryetar
Ulf Leichsenring	- Zëvendëskryetar
Johannes Kellner	- Anëtar

**Komiteti i kontrollit** ka këto detyra:

- a) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
- b) shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
- c) propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;

- ç) bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
  - d) kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;
  - dh) i jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
- e) miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

### **Drejtoria/Bordi i Menaxhimit**

Christian Canacaris	- Drejtori i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai	- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm
Elona Mullahi (Koci)	- Anëtare Bordi për Biznesin e Korporatave
Egon Lerchster	- Anetar Bordi për TI-në dhe Operacionet

### **Drejtoria**

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.
2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.
3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.
4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

### **Politika e konfliktit të interesit në Raiffeisen Bank Shqiperi**

1. Konfliktet e interesit

#### **1.1. Rregulla të Përgjithshme**

Konflikti i interesit midis kërkesës dhe ofertës është prezent në çdo transaksion bankar, siç është prezent edhe në transaksione të tjera të sistemit ekonomik. Interesi i njëres palë për të vendosur cmimin me të lartë, ka konflikt me interesin e palës tjetër për të paguar cmimin me të ulët për mundësisht vlerën me të madhe. Nuk ka konflikt interesi të kundraligjshëm përse kohe ky konflikt zgjidhet në treg në mënyrë të duhur, nga një marrëveshje e duhur që është në përputhje me atë çfarë dy palët bien dakort.

Gjithashtu, te parendesishme jane edhe konfliktet e interesit qe nuk kane mundesi te demtojne klientin, ose konfliktet personale te interesit midis punonjesve dhe klienteve, pa efekte financiare. Duke patur parasysh intereset e ndryshme te bankes, punonjesve dhe klienteve, konfliktet e interesit mund te krijohen nga dhuratat, ftesat, shperblimet, maredheniet e ngushta, punesimet shtese si edhe perfitimet qe lidhen me sherbimet shtese te sigurimit.

Konfliktet e Interesit mund te jene te nje natyre material qe ndikojne mundesine e pergjithshme te nje punonjei per te marre vendime objektive, te pavarura dhe te duhura dhe/ose te influencojne ne performance e detyrave dhe pergjegjesive. Ky eshte rasti nese konflikti i interesit paraqet nje risk material (psh mund te shtremberojne mundesine e kryerjes se detyrave ne menyre te pavarur dhe objektive dhe mund te ndikojne ne te kundert te interesave te Bankes), dhe nese nuk mund te parandalohet, mitigohet ose menaxhohet ne menyren e duhur ne perputhje me rregullat e vendosura ketu.

Persa i takon konflikteve te interesit, banka eshte e detyruar te ndermarre veprimet ne vijim:

- Ti identifikojne
- Ti regjistroje
- Ti monitorije
- Ti shmangi (dmth te parandaloje realizimin e ndonje konflikti potencial) dhe
- Ti beje te ditura nese nuk ka mundesi ti shmange

Zyra e perputhshmerise ka krijuar nje process per te permbushur keto veprime dhe hapat kryesore te procesit jane:

- identifikimi
- analiza, menaxhimi dhe mitigimi
- raportimi
- dokumentimi dhe
- eskalimi kur eshte i nevojshem

Punonjesit duhet te marrin vendimet e tyre, ne menyre te pavarur dhe objektive dhe pa qene te influencuar nga interesat e tyre private, mbi bazen e fakteve dhe ne perputhje me ligjet e aplikuar. Nje konflikt interesi mund te lindi nga interesa te kunderta te punonjesit ose personave te tij te ngushte familjare (percaktuar me poshte) ose njesive te lidhura ngushtesisht (percaktuar me poshte) me interesat e Bankes, dhe qe mund te impaktojne nje vendimarrje objektive dhe te pacenuar e cila mund te impaktojne negativisht interesat e Bankes.

"Persona te ngushte familjare" perfshin:

- partner (bashkeshorti/ja, i/e fejuara, bashkejetuesi/ja)
- femije (perfshire edhe ata te adoptuar)
- prinder, njerku/a,
- vjeherrit
- motra/vellezer, partneret respektive dhe femijet e tyre
- kunata/kuneter (motra/vellezer te partnereve sipas specifikimit me lart)
- ungjer (teze/halla/daja/xhaja)
- niper/mbesa,

- kusherinjte e pare

Njesite konsiderohen te lidhura ngushtesisht me nje punonjes (Njesite e lidhura ngushtesisht), nese plotesohet nje nga kushtet ne vijim ne lidje me njesine ligjore:

- interesa financiare direkte ose indirekte (psh nepermjet nje partneriteti, joint-venture, ose pjesemarrje) te punonjesit dhe personave te ngushte familjare, duke perfshire interesat financiare te personave te trete duke vepruar ne emer te punonjesit ose personit te lidhur familjar, ose
- detyrim I konsiderueshme financiar I punonjesit ose personit te lidhur ngushte familjar, ose
- nje pozicion menaxhimi keshilli drejtues ose drejtorie te mbajtur nga punonjesi (pervecse pozicionit te mbajtura ne grupin RBI), ose
- nje pozicion menaxhimi keshilli drejtues ose drejtorie te mbajtur nga nje person I ngushte familjar te punonjeist, ose
- nje marreveshje keshillimi ose kontrate punesimi (dytesore) e punonjesit, ose
- nje punonjes eshte I lidhur ngushtesisht ne nje menyre tjeter me njesine, sic percaktohet ne ligjet lokale te aplikuara ne lidhje me konfliktin e interesit

“Detyrim financiar I konsiderueshem” konsiderohet cdo detyrim financiar qe eshte I larte ne krahasim me burimet financiare te punonjesit (ose peronave familjare te ngushte respektive).

Nje konflikt potencial interesi mund te lindi ne rastet e pershkruara ne vijim, nese punonjesi perkates eshte i perfshire ne ndonje vendimarrje dhe/ose performimi i detyrave dhe pergjegjesive te tij/saj mund te influencohet negativisht ne lidhje me keto suate. Konfliktet potenciale te interesit te dhene me poshte nuk jane shteruese dhe mund te kete situatata te tjera konfliktesh materiale qe nuk pershkruhen ketu. Ne situatat e pershkruara ne vijim, jepet vetem nje tregues i pergjithshem qe nje konflikt interesi mund te ekzistojte. Ekzistenca e nje suate konfliktit interesi (psh vendimarrja e punonjesit respektiv mund te ndikohet negativisht nga interesat e vete private), materialitetit dhe cilat masa mitiguese jane te duhura, duhet te vleresohen dhe zgjidhen gjithnje rast pas rasti, duke konsideruar faktet dhe rrethanat e cdo rasti individual.

- Lidhje Aktiviteti/Biznesi

Nje konflikt potencial interesi mund te lindi nese Banka angazhohet ne maredhenie biznesi dhe/ose konkludon transaksione me nje punonjes, familjaret e tij te ngushte apo njesite e lidhura ngushte

- Procedurat Ligjore

Nje konflikt interesi mund te lindi nga perfshirja e nje punonjesi, ose e personave familjare te ngushte ose nje njesie te lidhur ngushte ne ndonje procedure ligjore kunder Bankes apo filialeve te saj.

- Ndryshime te funksionit brenda te njejtut institucion

Nje konflikt interesi mund te lindi ne lidhje me disa vendime te caktuara ne rast te ndryshimit te funksioneve brenda Bankes (psh nje punonjes qe me pare ka punuar per nje zone biznesi kalon ne nje zone risku apo kontrolli). Konflikti mund te lindi ne lidhje me kontrollin e vendimeve dhe

aktiviteteve te biznesit te meparshme, ne te cilat personi eshte perfshire ne pozicionin e meparshem

- Lidhjet personale, profesionale ose te biznesit me kompani me konflikte interesi

Nje konflikt interesi mund te lindi nese nje kompani tjeter me konflikte interesash (psh konkurrencte, kliente materiale, ofruer material, keshillime apo sherbime te tjera) eshte nje njesi e lidhur ngushte e punonjesit (ose ndonje personi te lidhur familjar) dhe/ose nese punonjesi (ose personi i lidhur familjar) mban nje pozicion ne trupin menaxhues te nje kompanie te tille ne 2 vitet e fundit, ose punonjesi angazhohet ne biznes ne Banke per llogarine e tij apo te pale te trete.

- Lidhje personale, profesionale, tregtare me Banken, anetaret e Drejtorise, Punonjesve kyc ose punonjesve te tjere

Lidhjet personale, profesionale, tregtare mund te cojne ne nje situatë konflikti te mundshem. Per shembull, lidhje personale te ngushta (sic jane percaktuar per personat e ngushte familjare) me anetare te trupave drejtues, pozicione kyce apo punonjes te tjere te Bankes apo filialeve te saj, mund te rezultojne ne situatë konflikti te mundeshem interesi. E njejta gje ndondh per bizneset apo maredheniet e tjera tregtare te punonjesit apo personit te ngushte familjar (personalisht apo nepermjet nje kompanie) me Banken, filialeve te saj dhe per interesat financiare (nepermjet partneriteteve, joint-venture apo pjesemarrjes) ose detyrimeve te konsiderueshme financiare ne/ndaj Bankes dhe filialeve te saj.

- Pozicion me nje influence politike

Nje konflikt interesi mund te lindi nese nje punonjes mban nje pozicion apo ka influence politike tani apo gjate 2 viteve te fundit dhe ka detyrime apo fuqi te vecanta te trasheguara, te cilat mund te bejne punonjesin te mos marri vendimin e duhur ne interesat e Bankes.

- Dhuratat dhe Ftesat

Dhuratat, ftesat dhe perfitime te tjera materiale dhe jo materiale jane problematike ne jeten profesionale, sepse atom und te kene influencen e gabuar ne vendimet e biznesit dhe mund te rezultojne ne nje konflikt interesi (ne vecanti kur lidhet me nje marreveshje konkrete biznesi). Si rrjedhim, dhuratat dhe ftesat e ofruara nga punonjesit ndaj paleve te treta, si edhe ato te ofruara nga palet e treta ndaj punonjesve, duhet te raportohen tek Zyra e Perputhshmerise.

- Tregjet e Kapitalit dhe konfliktet e lidhura te interesit

Nje konflikt interesi potencial mund te lindi ne lidhje me ofrimin e sherbimeve te intestimeve apo te transaksioneve te punonjesve.

E rendesishme eshte qe zyra e perputhshmerise te krijojë nje proces ku punonjesit (perfshire edhe anetaret e drejtorise) sigurojne qe interesat e tyre personale nuk kane konflikt me ato te detyrave per te cilat jane pergjegjes.

Konfliktet potenciale te interesit duhet te aprovohen nga drejtoria (per anetaret e drejtorise ky vendim merret nga Drejtori i Pergjithshem, dhe per Drejtorin e Pergjithshem nga Drejtuesi i Keshillit Drejtues) ne raportin vjetor per Drejtorine, ose Oficerin Lokal te Perputhshmerise. Ne vijim jepem rastet, subject per aprovim/autorizim:

- Perfshirja personale, direkt ose indirekt, ne ndonje transaksion qe perfshin banken

- Negocimi apo arritje marreveshesh ne emer te bankes, me nje subjekt ku vete punonjesi, kusheriri I tij/saj, shoku tij/saj, ose ndonje pale tjetere e trete me te cilin ka nje maredhenie te ngushte, ka nje lidhje nga ku mund te perfitoje ndonje apo te gjitha palet
- Intereresimi per punesim, drejtim, keshillim, ortakeri apo dicka te ngjashme, jashte banke
- Pranimi apo vazhdimi i punesimit me banken, kur ky person ka nje maredhenie te ngushte me dike dhe mund te kene konflikt interesi me detyrat qe kane si pergjegjesi. Sidomos, aktivitetet qe jane subjekt i nje kontrolli te dyfishte, nuk duhet te kryhen nga persona qe kane lidhje me njeri tjetrin
- Te gjitha punonjesit qe kane qellim te perfshihen ose finalizojne nje marreveshje mbi nje prone te paluajtshme, kolater ose prone te Bankes, duhet te njoftoje zyren e Perputhshmerise dhe shefin direkt per kete dhe duhet ta marri aprovimin paraprak te tyre
- Perpara hyrjes ose perfundimit te nje marreveshje private mbi nje pasuri te paluajtshme, punonjesit e RBAL, duhet te sigurojne qe nuk kane asnje konflikt interesi te cdo lloj natyre, lidhur me procesin apo personat te perfshire ne te, dhe veprimet e tyre nuk cenojne reputacionin dhe interesat e RBAL
- Nese konsiderohet e nevojshme nga Perputhshmeria, duhet marre aprovim paraprak nga Drejtoria

Zyra e perputhshmerise dokumenton deklaratat e konfliktit te interesit dhe cdo konflikt tjetere interesi te identifikuar, ne databazen e Konfliktit te Interesit, si dhe dhe kontrollon transakcionet e lidhura me ta.

Konflikte jo te lejuara interesi, mund te ekzistojne midis klienteve te bankes me kategorie ne vijim:

- Vete banken
- Personave qe punojne per banken (drejtoria, punonjesit, kontraktore te pavarur, agjente me kontrate)
- Kompanive qe kontrollohen nga banka. Nje kompani kontrollohet nga banka nese banka:
  - Ka te drejten e shumices se te drejtave votuese te aksionereve, ose
  - Ka te drejten si aksioner te vendosi apo heqi shumicen e struktruave administrative, te drejtorise apo keshillit drejtues, ose
  - Ka te drejten te ushtroje nje influence kontrolluese, ose
  - Mund te vendosi ne ushtimin e shumices se te drejtave votuese per vendosjen apo heqjen e shumices se anetareve te drejtorise apo keshillit drejtues, bazuar ne nje marreveshje aksioneresh me aksionere te tjere

Kompanite e kontrolluara nga banka, duhet te respektojne rregulloret ne fuqi persa i takon transakcioneve ne instrumenta financiare, te bejne te mundshme per banken te gjitha informacionin ne dispozicion dhe te dergojne raporte.

- Klienteve te tjere te bankes

Rregullat per konfliktin e interesit aplikohen ne te gjitha transakcionet ne instrumenta financiare te aplikueshme ne banken Raiffeisen ne Shqiperi.



Nese menaxhimi i kimit financiar/zyra e perputshmerise, ne luften kunder mitmarrjes/mitdhenies dhe korrupsionit, identifikon konflikte interesi, atehere keto regjistrohen ne listen e konflikteve dhe ndiqen sic duhet.

Konfliktet e interesit mund te lindin gjithashtu edhe ne nivel institucioni (psh si rezultat i aktiviteteve te ndryshme dhe roleve te Bankes brenda qellimit te nje konsolidimi apo te linjave te ndryshme te biznesit ose njesive brenda Bankes, ose ne lidhje me palet e jashtme).

Ne pergjithesi, situatat e konflikteve potenciale te interesit ne nivel institucioni, menaxhohen nga grupi RBI, nepermjet ndarjes se duhur te detyrave, barrierave perkatese te informacionit, si edhe procedurave te duhura per transaksionet me palet e lidhura.

Per me teper, cdo ndryshim organizativ analizohet gjithashtu nga Zyra e Perputshmerise ne lidhje me konfliktet potenciale te interesit dhe ne rast te nje konflikti potencial te idenifikuar, merren masat mitiguese pasi eshte vleresuar suate e konfliktit potencial me Drejtuesin e Divizionit/Anetarin e Drejtoriese dhe/ose Drejtorine.

Nese materializohet nje konflikt potencial interesi ne nivel institucional (psh kur risku nuk eshte menaxhuar akoma sic duhet nepermjet ndarjes se detyrave, barrierave respektive te informacionit dhe/ose procedurave te duhura per transaksionet me palet e lidhura), atehere kjo suate konflikti potenciale interesi duhet raportuar tek Zyra e Perputshmerise dhe duhen marre masat e duhura nga ana e Bankes per te parandaluar konfliktet e interesit dhe ndikimin negativ ndaj interesave te klienteve te tij.

Ne rast te transaksioneve te biznesit (perfshire edhe zgjedhjen e partnerit te biznesit), personat e lidhur duhen analizuar nese kane nje konflikt potencial interesi te nje niveli personal apo institucional.

Nese lind nje konflikt potencial interesi (psh kur risku i lindur nuk eshte menaxhuar akoma sic duhet), duhet te informohet Zyra e Perputshmerise/Menaxhimi I Kimit Financiar.

Nese nje konflikt nuk mund te vleresohet sic duhet nga personat e lidhur (psh ne rast te konfliktete te interesit te gjera ne grup), personat perkates duhet te raportojne te gjitha faktet dhe te kerkojne udhezime nga Zyra e Perputshmerise/Menaxhimi I Kimit Financiar. Zyra e Perputshmerise/Menaxhimi I Kimit Financiar do te vleresoje objektivist konfliktin potencial te interesit dhe do te jape rekomandimet e duhura te mitigimit, te cilat duhet te konsiderohen nga trupat vendimarrjes perkates.

Detaje te metejshme mbi konfliktet e interesave qe lidhen me Perputshmerine e Tregjeve te Kapitalit dhe Luften Kunder Mitmarrjes/mitdhenies e Korrupsionit, ne procesin e identifikimit dhe analizes, menaxhimit dhe mitigimit, monitorimit dhe shmangies nese eshte e mundur, regjistrimit dhe dokumentimit, raportimit dhe eskalimit, ne RBAL, jepen ne Proceduren Operacionale te Menaxhimit te Konfliktit te Interesit ne Banken Raiffeisen ne Shqiperi.

## **1.2. Identifikimi, Vleresimi dhe Raportimi**

Te gjithë punonjesit janë të detyruar të raportojnë menjëherë çdo konflikt interesi potencial, aktual apo të menduar (përfshirë psh dhuratat dhe ftesat e ofruara apo të marra nga palet e treta, marrëdhëniet e ngushta, punët dytësore, funksionet si partner në një partneritet, kompani dhe mandatet politike) tek drejtuesi direkt si edhe tek Zyra e Perputhshmerisë. Të tjera konflikte interesi mund të raportohen nga anëtarët e Drejtorisë, punonjës të tjerë apo pale të treta.

Punonjesit dhe departamentet e përfshira, janë përgjegjëse për identifikimin dhe raportimin e konflikteve potenciale të interesit. Zyra e perputhshmerisë mbikqyr këtë proces dhe e detyron atë nëse është e nevojshme. Mundësitë prezente në zonat e biznesit të bankës, për konflikte të palejueshme të interesit, listohen dhe nënndahen sipas zonës së biznesit, në Databazën e Konfliktit të Interesit/Platforma "Cockpit".

Perpara se banka të hyjë në një marrëdhënie biznesi, interesash apo punësh në fusha të reja biznesi, punonjesit e lidhur me të duhet të kontrollojnë për konflikte potenciale interesash, duke patur parasysh kategorinë e personave që mund të përfshihen në një konflikt interesi. Nëse identifikohet një mundësi konflikti, duhet të raportohet tek zyra e perputhshmerisë nëpërmjet deklaratës së konfliktit të interesit të anëtarëve të komisionit dhe deklaratës së paleve të treta. Atje deklarohet përmbajtja e konfliktit potencial dhe personat që mund të impaktohen (kliente, punonjës, pale të treta).

Punonjesit e përfshirë në një biznes apo interes duhet të bëjnë një raport për zyrën e perputhshmerisë edhe nëse:

- Situatat që sjellin një konflikt potencial interesi ndodhin vetëm pasi janë kryer transaksionet ose
- Ka një ndryshim në situatat e raportuara me parë dhe këto paraqesin një konflikt potencial interesi

Zyra e perputhshmerisë duhet të japë punonjesve apo departamenteve të përfshira, informacion dhe instruksione të qarta, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të identifikojnë konfliktet potenciale të interesit dhe të raportojnë ato tek zyra e perputhshmerisë. Zyra e perputhshmerisë mirëmban një listë konfidenciale të konflikteve në formën e një databaze edhe sistemi (Cockpit, platforme e grupit Raiffeisen), e cila është e njohur vetëm për zyrën e perputhshmerisë. Lista e konflikteve (në databazë dhe sistem) bazohet kryesisht në vetedeklarimet e konflikteve të interesit, në deklaratimet e konflikteve nga anëtarët e komisioneve, në deklaratimet e konflikteve nga palet e treta, dhe:

- Në një analizë të zonave aktuale të biznesit të bankës dhe konflikteve potenciale të identifikuar dhe
- Në regjistrimin e situatave që mund të çojnë në konflikte interesi (si psh disa aplikime për kredi, marrëveshje për keshillime, anëtarësime në drejtori kompanish, porosi të mëdha, funksione që bashkëdrejtojnë), marrëdhëniet me të rëndësishme të jashtme (duke përfshirë por pa u limituar në zonën e blerjeve) dhe interesave të rëndësishme për bankën

Lista e konflikteve ka per qellim te siguroje nje pamje te pergjithshme te konflikteve jo te lejuara te mundshme, qe bien pjese e zonave te ndryshme te biznesit dhe marredhenieve te biznesit te bankes.

Zyra e Perputhshmerise/Menaxhimi I Krimet Financiar vendos mbi ekzistencen apo jo te nje konflikti interesi (psh qe situata respektive mund te ndikojte negativisht performance e detyrave dhe vendimeve te punonjesve), materialitetin e tij dhe masat qe duhet te merren ne perputhje me seksionin 9.4, si edhe ne perputhje me rregullore te tjera per te menjanuar ose mitiguar keto konflikte interesi. Zyra e Perputhshmerise/Menaxhimi I Krimet Financiar do te regjistroje konfliktin e interesit ne databazen/platformen "Cockpit".

Banka duhet te jete ne perputhje me detyrimet njoftuese ne lidhje me konfliktet e interesit ne autoritetet kompetente sipas ligjit lokal.

### **1.3. Masa per Parandalimin e Realizimit te Konflikteve Potenciale te Interesit**

Konfliktet pontenciale te identifikuara nuk duhet te kthehen ne konflikte reale. Masa te pergjithshme zbatohen per te shmangur ose menaxhuar konfliktet e interesit. Keto perfshijne por nuk limitohen ne:

Nese ne ndonje rast te vecante, behet e nevojshme te devijohet nga ndonje mase e dhene ne kete rregullore, atehere duhet te dorezohet nje deklarate konflikti interesi dhe kjo regjistrohet ne databazen e konflikteve te interesit.

Per te parandaluar qe konfliktet potenciale te interesit te behen reale, ne pergjithesi duhet te respektohen principet ne vijim:

- Dhuratat dhe perfitimet per punonjesit: Ne te gjitha zonat e biznesit punonjesit ne pergjithesi jane te ndaluar te marrin Dhurata apo incentiva te tjera
- Shkembim informacioni: Banka ndalon shkembimin e informacionit midis personave perkates te perfshire ne aktivitete ku ka konflikt interesi
- Sistemi I kompensimit te bankes siguron heqjen e ndonje lidhje te drejtperdrejte midis shperblimit te personave te perfshire kryesisht ne nje aktivitet te caktuar dhe shperblimit ose te ardhurave te fituara nga persona te perfshire kryesisht ne nje aktivitet tjetër, ku mund te krijohet nje konflikt interesi midis ketyre aktiviteteve
- Zyra e perputhshmerise duhet te kete versionet me te fundit te strukturave organizative qe tregojne pergjegjesite dhe te kete autoritetin te japi instruksione per te parandaluar ose limituar cdo person nga te ushtruarit e nje influence jo te duhur mbi menyren qe nje person i caktuar kryen investime ose sherbime shtese ose aktivitete dhe te parandaloje ose te kontrolloje perfshirjen e menjehershme, ose te vazhdueshme te nje personi te caktuar ne nje investim ose sherbime shtese ose aktivitete ku kjo perfshirje mund te demtojte menaxhimin e duhur te konflikteve te interesit. Perputhshmeria jep instruksione per te garantuar kontrollin e ndare te personave perkates, funksionet kryesore te te cileve perfshijne aktivitete ne emer ose qe i sigurojne sherbime klienteve, me interesat te te cileve mund te kete konflikt, ose kush perfaqeson interesa te ndryshme qe mund te kene konflikt midis tyre, perfshire edhe ato te firmes.

- **Krijimin e Zonave Konfidenciale:** Banka krijon zonat konfidenciale ne menyre te tille qe zonat e biznesit jane te ndara ne kufijte e mundshem te konfliktit dhe ku qarkullimi i informacionit midis tyre eshte i ndaluar ose kontrollohet. Banka i ka percaktuar zonat e konfidencialitetit ne Rregulloren mbi Rregullat e Perputhshmerise per Zonat Konfidenciale. Nuk lejohet qe informacioni te transmetohet midis ketyre zonave, pa njohurine e pergjegjesit perkates se zones se konfidencialitetit dhe depertimi i informacionit/wall crossing kufizohet ne cfare eshte absolutisht e nevojshme (qe njihet si nevoja per te patur informacion). Nje raport i konfliktit dorezohet prane zyres se perputhshmerise sic eshte parashikuar ne Proceduren Operacionale te Menaxhimit te Konfliktit te Interesit. Punonjesit qe levizin nga nje zone tek tjetra perkohesisht ose pergjithunje (si psh gjate nje projekti), nuk duhet te perdorin ose te japin informacionin konfidencial qe ata kane nga zona e meparshme, derisa te plotesohet dhe dorezohet nje raport konflikti (sic eshte pershkruar ne procedure operacionale dhene me lart. Gjate kryerjes se detyrave ne pune, punonjesit e zonave konfidenciale mund te marrin informacion qe mund te ndikojne ne kushtet e tregut per tregtimin e letrave me vlere, monedhave, metaleve te cmuara dhe produkteve derivative. Si rrjedhim, ata jane subjekt rregullash te vecanta edhe per transaksionet e tyre personale ne letra me vlere.

Per te shmangur konfliktet e interesit ne zona te vecanta biznesi, vendosen principe per kete zona. Zonat e biznesit perfshijne por nuk limitohen ne keshillime investimi dhe rekomandime investimi, analiza financiare, procesimin e kerkesave te klientit ose kujdestari.

#### **1.4. Masat qe merren kur Konflikti i Interesit ka ndodhur**

Nese pavaresisht masave te marra, konflikti i interesit ndodh, duhet te ndiqe procedura ne vijim:

- **Raportimi i Konfliktit te Interesit Aktual:** Nese nje konflikt interesi ndodh, ose nese ka nje dyshim te bazuar qe do te ndodhi, menjehere dhe pa asnje perjashtim, njoftohet zyra e perputhshmerise (Raporti i Konfliktit). Ne Raportin e Konfliktit duhet te deklarohet thelbi i konfliktit te interesit, palet e perfshira/afektuara (klientet, punonjesit, palet e treat) dhe hapat e propozuara nga njesia e biznesit per te zgjidhur konfliktin. Zyra e perputhshmerise mund te kerkoje gjithashtu informacion dhe dokumenta ne cdo moment, nese dyshon nje konflikt interesi
- **Perditesimi i databazes/platformes se Konfliktit te Interesit:** Zyra e perputhshmerise duhet te dokumentoje (si vijon) raportet e konfliktit dhe cdo konflikt qe identifikon vete ne databazen e Konfliktit te Interesit. Dokumentimi konsiston ne informacionin me poshte:
  - Daten ne te cilen eshte raportuar konflikti i interesit ose daten ne te cilen Perputhshmeria identifikoi konfliktin
  - Permbajtjen e konfliktit te interesit
  - Nese pranohen konflikti i interesit dhe risqet e lidhura
  - Hapat e ndermarre per te mitiguar apo zgjidhur konfliktin e interesit
 Zyra e Perputhshmerise do te monitoroje vazhdimin e metejsheem te transaksionit. Platforma "Cockpit" ne rastin e punonjesve qe kane akses, popullohet nga keta te fundit dhe mirembahet nga zyra e perputhshmerise. Oficeri Lokal i Perputhshmerise eshte

pergjegjes per te vendosur heqjen apo jo te transaksioneve nga databaza e Konfliktit te Interesit.

- Zgjidhja e konfliktit aktual te interesit: Zyra e perputhshmerise vendos nese, pervec hapave te propozuara nga njesia e biznesit ne raportin e konfliktit, duhet te ndermerren apo jo hapa te tjere per zgjidhjen e konfliktit. Vendimi merret ne menyre te pavarur, mbi bazen e rregullave te statutit dhe direktivave per menaxhimin e konfliktit te interesit. Kur merret vendimi per masat mitiguese, duhet te kihet parasysh nese konflikti i interesit vazhdon dhe duhet te menaxhohet ne menyre te qendrueshme apo nese lind ne nje situatë te vecante dhe mund te menaxhohet me nje mase te njehershme. Ne te gjitha rrethanat, interesat e Bankes duhet te jene kryesoret ne vendimet e marra.

Per konflikte interesi jo te rendesishme dhe/ose te perkohshme, eshte i mjaftueshem deklarimi i ketij konflikti dhe dokumentacioni perkates (ne varesi te rrethanave dhe te rastit perkates), sebashku me argumentimin per parendesine e tij. Per shembull, mbullja e transaksioneve bankare te cdo dite te mbyllura brenda standarteve te tregut, midis nje punonjesi, personi te ngushte familjar ose njesie te lidhur ngushte dhe Bankes mund te konsiderohet si jo i rendesishem, duke u siguruar qe keto transaksione nuk jane subjekt i ndonje ligji lokal per konfliktin dhe kerkeses me masa te tjera mitiguese.

Disa konflikte interesi mund te mitigohen nga Zyra e Perputhshmerise me detyrimet e punonjesve per konfidencialitetin, sic kerkohet ne kontraten e punes ose nga ndonje ligj i aplikuar lokal.

Ne rastin e nje konflikti interesi te qendrueshem, material, te papajtueshem te nje punonjesi, qe ndikojne mundesine e tij te pergjithshme per te marre vendime te duhura, objektive dhe te pavarura, duhet te konsiderohen si te nevojshme masa te tjera (psh ndryshimi i pozicionit te punonjesit ose si vendim i fundit edhe nderprerja e kontrates se punesimit).

Konflikte te tjera interesi mund te mitigohen sic duhet duke perfunduar ose mosaprovuar funksione/pozicione ne kompani me konflikte interesi. Ne vencanti, nese nje punonjes ka per qellim te pranoje nje funksion jashte Banke, kjo kerkon aprovimin me pare nga Zyra e Perputhshmerise. E njejta gje aplikohet nese nje punonjes ka per qellim te angazhohet ne aktivitete biznesi per llogari te tij ose per llogari te nje pale te trete, ose nese duan te lidhen me nje kompani tjeter operative si partnere. Mos perputhshmeria me rregullat e kesaj rregulloreje mund te rezultojë me ndryshim pozicioni te punonjesit, dhe ne rastin me te keq ne pushimin nga puna dhe/ose kerkimin e demshperblimit.

Ne vendimin per hapat qe do merren, duhet te behen perpjekje qe te rregullohen interesat e klientit, ndaj te cilit konflikti i interesit ka shkaktuar nje disavantazh

- duke i vendosur para interesave te bankes apo personave qe punojne per te dhe
- sa me baraz ne prioritet me interesat e klienteve te tjere

Nese kjo nuk eshte e mundur, per te zgjidhur konfliktin e interesit, zyra e perputhshmerise ben qe njesia e biznesit te zgjedhi midis dy masave ne vijim:

- Moskryerjen e transaksioneve
- Berjen e njohur te Konflikteve te Interesit

- Berja me dije: Berja me dije e konflikteve te interesave tek klientet eshte nje mase e fundit, qe perdoret vetem kur te gjitha masat organizative dhe administrative te vendosura per te parandaluar ose menaxhuar konfliktet e interesave, nuk jane te mjaftueshme per te siguruar, brenda nje confidence te arsyeshme, parandalimin e risqeve te demtimit te interesave te klientit.

## **II AVANTAZHET (STIMUJT)**

### **1 PARIME**

Me qëllim të kryerjes së shërbimeve në një mënyrë që i shërben interesit të palëve, banka do të frenohet në pagimin, apo pranimin e komisionit, pagesa, apo përfitime jo-monetare ('avantazhe' ose 'stimuj') në qoftë se këto stimuj, nga natyra ose vlera e tyre janë në gjendje të dëmtojnë interesat e klientit në krahasim me interesat e vetë bankës dhe përfitimet e dhëna klientëve.

### **1 STIMUJT E LEJUAR**

Stimujt janë të lejuar vetëm në qoftëse janë prezent të gjithë kushtet në vijim:

- Ekzistenca, natyra dhe shuma e stimulit ose- në qoftë se shuma nuk mund të përcaktohet- mënyra e kalkulimit shumës apo rangjeve është zbuluar për klientin në mënyrë komprehsive, me saktësi dhe në mënyrë gjithpërfshirëse para dhënies së shërbimit përkatës për letrat me vlerë apo shërbimet ndihmëse dhe
- Pagimi apo ofrimi i avantazhit është përgjithësisht- bazuar në kuptimin të paktën mbi një klient të caktuar dhe/ose grupe produktesh-projektuar për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të kryer për klientin dhe
- Nuk ka interferencë me detyrën e bankës për të vepruar në interesin më të mirë të klientit.

### **2. MARRJA E VENDIMIT NËSE STIMUJT JANË TË LEJUAR**

Specialisti i Përputhshmërisë duhet të rishikojë në avancë çdo marrëveshje sipas së cilës banka jep ose merr stimuj, me qëllim përcaktimin nëse ato janë të lejueshme ose jo. Marrëveshjet do t'i jepen Specialistit të Përputhshmërisë në avancë për këtë qëllim. Asnjë marrëveshje nuk mund të konkludohet për stimujt, në qoftë se Specialisti i Përputhshmërisë mendon se ajo është e papranueshme.

### **3. DEKLARIMI**

Pikat kyçe të një marrëveshje apo stimujt do t'i zbulohen klientit në një formë të përmbledhur. Detajet shtesë do t'i zbulohen klientit me kërkesën e tij/saj. Forma dhe përmbajtja e zbulimit duhet të aprovohet me shkrim nga Përputhshmëria.